

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 13.02.2019	(dy). 1 seancë dëgjimore + 1 seancë dhënie vendimi
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë KPK). Objekti: Procesi i Vettingut të subjektit të rivlerësimit z. Artan Bajrami		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Artan Bajrami		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u zhvillua në intervalin kohor 09:30-10:25. Trupa gjyquese e KPK u tërhoq për të marrë vendimin, duke shtyrë seancën të nesërmen për efekt të shpalljes së vendimit		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Shpallja e vendimit është shtyrë për dt. 14 Shkurt, ora 09:30, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyquese (emrat)	Valbona Sanxhaktari - Kryesuese e trupit gjyques; Suela Zhegu - Relatore e çështjes; Brunilda Bektoshi - anëtar i trupit gjyques. Të pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar paraqitet, z. John Leonardo. i pranishëm pa shkëputje gjatë zhvillimit të seancës.		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Mbrojtja u realizua personalisht.		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Albana Misja		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Numri i anëtarëve nga publiku konstatohet të jetë rreth 20 persona, pavarësisht masave të sigurisë, me akses të plotë në hyrjen e godinës dhe pjesëmarrje fizike në seancën dëgjimore. Akomodimi u krye në formë të rregullt nga stafi menaxhues i KPK.		
Media e pranishme:	Mediat lokale ishin të pranishme, me përafërsisht 9 përfaqësues, me akses të plotë në hyrjen e godinës. Megjithatë pjesëmarrja e tyre u lejua vetëm në fazën përgatitore të seancës dëgjimore, pas së cilës largohen nga salla së bashku me mjetet e regjistrimit, referuar nenit 3 të Rregullores "Për marrëdhëniet me median".		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj?
	Po	Trupa gjyquese vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht dhe të paraqesë rezultatet e tij për të tre kriteret e rivlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale dhe etike.	Subjekti pranoi rezultatet e hetimit administrativ kryer nga komisioni, për komponentët e Figurës dhe Aftësive Profesionale, duke kundërshtuar gjetjet lidhur me kriterin e Pasurisë
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës?
	Referuar të dhënave në Raportin Vlerësues të ILDKPKI dorëzuar pranë Komisionit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit konstatohet se: Deklarimi është i saktë, ka burime të ligjshme, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, nuk është në kushtet e konfliktit të interesave	Të dhëna nga raportet e ILDKPKI	Komisioni nuk deklaroi në seancën dëgjimore aktet provuese mbi të cilat mbështeti rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e Pasurisë

D1. Pasuria	Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, dhe kryerja e hetimit administrativ te pavarur, KPK konstaton këto pasuri të deklaruara: 1. - Apartament banimi, Tiranë, në vlerën 45.000 dollar, konfirmuar nga ZRPP Tiranë. Burim krijimi: Kredi në vlerën 5 milion Lek, të ardhura të përfituara nga shitja e një apartamenti në Gramsh, dhe kursime nga paga ndër vite. Në Deklaratën Vetting të vitit 2017, referuar pretendimit te KPK, subjekti nuk ka deklaruar që në shlyerjen e vlerës së këtij apartamenti ka qenë përcaktuese edhe huaja e dhënë nga baxhanaku i subjektit. Lidhur me këtë Komisioni përcakton se ka pasaktësi dhe mospërputhje deklarimesh nga ana e subjektit. Megjithatë sipas hetimit të kryer, komisioni konstaton se nga personi huadhënës ka burime financiare të mjaftueshme për të justifikuar dhurimin e mësipërm. 2- Apartament, Golem, i paregjistruar në ZRPP , me burim krijimi: kursime nga paga ndër vite. 3- Pasuri e paluajtshme e llojit Pyll dhe kullotë, përfutuar me vendim të KKKP, Gramsh. Burim krijimi: trashëgimi nga i ati. Komisionit i rezulton se kjo pasuri është deklaruar vetëm në Deklaratën e vitit 2014 dhe jo në deklaratat pararendëse. i kalon subjektit barrën e provës. Pasuritë nga persona të tjetër të lidhur: 1- Apartament Tiranë, në vlerën 9.8 milion lek, në pronësi të të bijës së subjektit. Burim krijimi: kursime familjare ndër vite, depozitë bankare, kursime nga e bija , si edhe një hua prej 20, 000 Eur, (për të cilën rezulton se huadhënësi ka burime financiare të mjaftueshme e të ligjshme). 2- Automjet, përdorur nga i biri. Nga hetimi i kryer kanë rezultuar pasaktësi. Përkatësisht në disa polica sigurimi subjekti rezulton si përdorues e në të tjera pronar. Ngrihen dyshime mbi pronësinë e kësaj pasurie dhe i kalohet barra e provës subjektit.	Relatori	
		Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit pretendon pakujdesi nga ana e tij në mos deklarin e pasurisë në Deklaratat e para 2014, si edhe pagesë të rregullt nga baxhanaku i tij provuar me mandat pagesat paguar drejtpërdrejt kompanisë sipërmarrëse	Subjekti i rivlerësimit	
		Ankesa nga publiku Përfaqësuesi i ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Të dhënat nga raporti i DSIK, në përputhje me N.39 të ligjit 84/2016 „konstatojnë vlerësimin: "I Përshtatshëm" për vazhdimin e zhvillimit të detyrës	Të dhëna nga raportet e DSIK	Komisioni nuk deklaroj në seancën dëgjimore aktet provuese mbi të cilat mbështeti rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e Figurës
	Komisioni nuk deklaroj rezultatet e hetimit të pavarur lidhur me këtë kriter	Relatori	
		Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. <u>Aprovon vendimarrjen e DSIK.</u>	Subjekti i rivlerësimit	
	Ankesa nga publiku Përfaqësuesi i ONM		
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Të dhënat nga grupi i punës së Prokurores së Përgjithshme tregojnë për aftësi dhe korrektësi në punë, aftësi lidhur me arsyetimin ligjor	Të dhëna nga grupi i punës së Prokurores së Përgjithshme	Provat e administruara gjatë hetimit të pavarur administrativ nga KPK, lidhur me këtë kriter vlerësues: 3 dokumente të zgjedhura nga subjekti dhe 5 dosje të përzgjedhura në formë rastësore si edhe të dhëna nga burime arkivore
	Komisioni raportoj vetëm mungesën e denoncimeve pranë KPK dhe bashkëpunimin në procedurat e hetimit nga ana e subjektit rivlerësues	Relatori	
		Mbrojtja	
	Subjekti i rivlerësimit konfirmon marrjen dijeni mbi dosjen dhe dokumentet provues. Miraton deklarinimet e KPK mbi përfundimet e hetimit administrativ lidhur me këtë pikë	Subjekti i rivlerësimit	

		Ankesa nga publiku	
		Përfaqësuesi i ONM	
E. Konkluzione dhe komente te monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e	<p>Aksesi i pjesëmarrjes, nga publiku, shoqëria civile, institucionet e tjera të interesuara dhe mediat lokale është respektuar. Etika e sjelljes së trupit gjykues është e rregullt dhe të folurit të kuptueshëm. Deklarohen nga relatori i çështjes dhe konfirmohen nga subjekti respektimi i te drejtave procedurale si: është njoftuar për procedurën e fillimit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupës gjykuese, për të cilët nuk ka pasur deklaram për konflikt interesi. është njohur me dokumentet e dosjes dhe të drejtat e saj në përputhje me K.Pr. A. I janë dhënë disa ditë kohë (8 ditë) për tu njohur me dosjen, dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe iu bën të ditura rezultatet e hetimit administrativ. i rezervohet e drejta përfaqësuesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe trupit gjykues të drejtojnë pyetje, dhe iu dha mundësia e fjalës në seancë dëgjimore subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit plotëson kriteret që referon ligji nr. 84/2016, Kodi i Procedurës Administrative (Nenet 45-47) dhe Aneksi shtojcë i Kushtetutës, referuar te drejtave procedurale dhe respektimit të elementeve përbërës të procesit të rregullt ligjor, mbrojtjes efektive, aksesit në gjykim, kohëzgjatjes së arsyeshme të seancës. Megjithatë Komisioni nuk deklaroi aktet provuese mbi të cilat mbështeti rezultatet e hetimit administrativ për dy nga kriteret e vlerësimit</p>		